



## NEWSLETTER

Prill 2024

Nr.4

### Përfaqësuesit e OSBE/ODIHR në një vizitë pune në ASHMA



Një delegacion i misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it, kryesuar nga ambasadorja Xhillian Stirk, më 4 prill ishte në një vizitë pune në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Tema kryesore e takimit ishte puna e Agjencisë gjatë Zgjedhjeve Presidenciale dhe Parlamentare 2024, duke përfshirë kornizën ligjore për përfaqësimin mediatik zgjedhor, si dhe mënyrën se si kryhet monitorimi i transmetuesve gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, ambasadorja e informoi Agjencinë për objektivat dhe shtrirjen e misionit të OSBE/ODIHR-it gjatë zgjedhjeve.

### U mbajt panel diskutim kushtuar reklamimit politik dhe integritetit zgjedhor



Në organizim të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Fondacionit Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES), më 3 prill u mbajt panel diskutimi "Reklamimi politik dhe integriteti i zgjedhjeve". Qëllimi i aktivitetit ishte inkurajimi i dialogut ndërinstucional mbi sfidat e integritetit zgjedhor në lidhje me reklamimin politik. Në hapjen e aktivitetit fjalën e mori drejtori i ASHMA-së, Dr. Zoran Trajčevski dhe Joana Kosma, drejtore e IFES në RMV-së. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe disa palë të interesuara, të cilët diskutuan për aspekte të ndryshme të mjedisit mediatik gjatë zgjedhjeve.

Përfaqësues të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Entit Shtetëror për Revizion, Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit Shtetëror për parandalimin e korrupsionit, diskutuan për sfidat në kornizën ligjore për reklamimet politike me pagesë, përvojat nga proceset e mëparshme zgjedhore dhe faktorët që ndikojnë në nxitjen e transparencës së reklamimit politik.

Në pjesën kushtuar reklamimit politik në nismat e reja legjislative të Bashkimit Evropian, përfaqësues të organeve rregullatore evropiane të medias nga Italia dhe Sllovakia ndanë informacion mbi rregullat për rregullimin e reklamimit politik në kodeksin e forcuar kundër dezinformimit të vitit 2022 dhe rregulloren mbi transparencën dhe shënjestrimin e reklamimit politik.

### Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele më 16 prill publikoi Raportin e dytë të monitorimit të pasqyrimt mediatik për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare, për periudhën nga 8 mars deri më 3 prill 2024. Monitorimi përfshinte shërbimet programore të nëntë shërbimeve programore kombëtare – TVM1; TVM2; TV Alsat-M; TV Alfa; TV Kanal 5; TV Sitel; TV Telma; TV 24 Vesti dhe TV 21-M, me fokus në shtojcat në edicionet qendrore të lajmeve/ditarit televiziv lidhur me temat parazgjedhore dhe zhvillimet aktuale shoqërore-politike vendase, si dhe lloje të tjera emisionesh me këtë tematike.

Siç pritej, në orët e rregullta të programeve për debate dhe intervista ishin të pranishme temat për kandidatët për kryetar, nga ku temë kryesore ishte vendosja e kandidatit Stevčo Jakimovski në "listën e zezë" të SHBA-së. Në lajme, përveç akuzave ndërpartiake dhe spekulimeve partiake, nuk munguan edhe shkrimet kritike të gazetarëve për problemet e menjëhershme aktuale që përmbanin paralajmërime ekspertësh, juridiko-ekonomike si dhe indicie të organizuara civile apo sindikaliste. Në numrin më të madh të rasteve, përmes debateve dhe intervistave doli në pah përvoja dhe profesionalizmi i gazetarëve, dhe me rëndësi të veçantë u treguan shtojcat e gazetarëve dhe emisionet e veçanta aktuale-informative në të cilat nxitësit dhe shtytësit e analizës objektive të gjendjes socio-politike në resor të ndryshëm ishin të bazuara metodologjikisht në kërkime të verifikueshme të sektorit civil ose të institucioni të huaj me interes real (financiar/konsultativ) në proceset e brendshme. Dhe këtë herë, në periudhën e monitoruar u vërejt mungesa e "anës së dytë" në debate dhe intervista në disa media.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur shkelje të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele nga ana e transmetuesve. Sa i përket personave me dëmtim të dëgjimit, vetëm TVM 1 dhe TV 24 Vesti kanë ofruar përkthim në gjuhën e shenjave në një nga edicionet e tyre të lajmeve. Raporti nga monitorimi i prezantimit mediatik për periudhën nga 8 mars deri më 3 prill 2024 është i disponueshëm në [link](#).



## NEWSLETTER

Në rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale 2024, gjatë monitorimit të prezantimit mediatic zgjedhor të programit TV Klan Maqedoni, transmetuar në periudhën prej 4 deri më 22 prill, Agjencia konstatoi shkelje të nenit 75 paragrafi 1, dhe në lidhje me nenin 75 paragrafi 4 nënparagrafi 1 të Kodit Zgjedhor, gjegjësisht televizioni nuk ka ofruar informacion për procesin zgjedhor në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, pra duke përdorur gjuhën e shenjave, titrat, përshkrim të zërit ose mjete të tjera për të siguruar aksesueshmërinë, as në të paktën një edicion lajmesh gjatë ditës, as në përmbajtje të tjera programore gjatë javës të transmetuar në periudhën nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Në TV Klan Maqedonia, Agjencia ka konstautuar shkelje dhe të nenit 76-b paragrafi 3, dhe në lidhje me nenin 69-a paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor, në programin e transmetuar më 23 dhe 24 prill, gjegjësisht gjatë raportimit për kohën e heshtjes zgjedhore për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, televizioni në disa programe/përmbajtje të tij ka transmetuar informacione dhe materiale audiovizuale në lidhje me ose në të cilat marrin pjesë pjesëmarrësit në zgjedhje. Për të dyja shkeljet është ngritur procedurë për kundërvajtje.

Në dy raste përmes njoftimeve publike Agjencia u ka kujtuar transmetuesve rregullat e Kodit Zgjedhor. Më 9 prill është njoftuar se me monitorimin e mediave zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024, është konstatuar se në kundërshtim me nenin 76 paragrafi 3 të Kodit Zgjedhor, në reklamën politike me pagesë të kandidatëve për kryetar Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani, marrin pjesë të mitur (fëmijë). Në njoftim theksohej se për përmbajtjen e reklamave politike me pagesë janë përgjegjës porositësit, dhe transmetuesit janë përgjegjës për ligjshmërinë e transmetimit të tij. Më 22 prill, Agjencia rikujtoi se nga mbrëmë në mesnatë fillon heshtja zgjedhore për rrethin e parë të Zgjedhjeve Presidenciale 2024 që vazhdon deri në orën 19:00 më 24 prill. U theksua se gjatë heshtjes, ndërpritet mbulimi mediatic në lajme dhe emisionet speciale informative të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore si për zgjedhjet presidenciale ashtu edhe për ato parlamentare, por lejohet transmetimi i përfaqësimit politik falas dhe reklamimi politik me pagesë i pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare. Të gjitha raportet dhe materialet lidhur me Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare janë të disponueshme në ueb-faqen [www.avmu.mk](http://www.avmu.mk), në banerin e veçantë "Zgjedhjet 2024".

### Njoftimet publike

Më 18 prill është reaguar ashpër për tentativën e TV Alfa për të bërë presion ndaj organit rregullator duke publikuar informacion keqdashës në emisionin "Fli nëse mundesh", transmetuar premierë më 16 prill, ku gazetari Goran Momirovski, ndër të tjera pohoi se Agjencia ndërhyr në politikën editoriale të TV Alfa, dhe se joformalisht po kërcënon TV Alfa se mund të mbyllet nëse nuk ka "ndonjë ekuilibër që është shumë subjektiv". Në reagim, ndër të tjera, është theksuar se që nga fillimi i fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale, punonjës të TV Alfa në disa raste iu drejtuan Agjencisë për shjegimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor, dhe për çdo kërkesë të tyre iu është përgjigjur në kohë. Në lidhje me konstatimin e gazetarit se që nga ASHMA buron kriteri sipas të cilit transmetuesit nuk do t'i rinovohet leja e transmetimit nëse nuk raporton në mënyrë të balancuar gjatë një procesi zgjedhor, u theksua se ky është një kriter i përcaktuar në LSHMAAV. Agjencia ka kërkuar nga TV Alfa që përgjigja e ASHMA-së ndaj pretendimeve të gazetarit Goran Momirovski të publikohet në edicionin e ardhshëm të emisionit "Fli nëse mundesh".

Në lidhje me informacionin e TV Uskana Media se një gazetar i këtij televizioni nuk është lejuar të inçizoj fragment (shtojcë) në lidhje me numrin e nxënësve dhe punonjësve të shkollës fillore Naim Frashri nga fshati Pirok, Komuna e Bogovinës, Agjencia më 18 prill ka rikujtuar se institucionet duhet të jenë të hapura dhe transparente dhe të bëjnë përpjekje maksimale që përfaqësuesve të mediave t'u ofrojnë (qasje) akses pa pengesë për informacionet e kërkuara. Në njoftim theksohet se punonjësit e medias gjatë kryerjes së punës së tyre, e cila është me interes publik, duhet të jenë të lirë nga çdo kërcënim dhe frikësim, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të tregojnë përgjegjësi profesionale dhe të respektojnë parimet dhe standardet etike të gazetarëve gjatë raportimit.

Më 12 prill, Agjencia dënoi etiketimin dhe diskreditimin e TV Kanal 5 përmes publikimit të kryetarit të partisë politike të Majtë Dimitar Apasiev në rrjetin social Facebook. Në njoftim është theksuar se me publikimin, kreu i së Majtës tregon një qëndrim jashtëzakonisht të pahijshëm, kërcënon lirinë e informimit dhe cënon dinjitetin e punonjësve të medias. Përdorimi i frazave vulgare, si dhe shprehjeve me të cilat ai mund të nxisë gjuhën e urrejtjes nga ndjekësit e tij në rrjetet sociale, është krejtësisht i papranueshëm dhe mund të kërcënojë sigurinë e punonjësve të medias. Politikanët dhe bartësit e funksioneve publike duhet të jenë të ndërgjegjshëm për peshën e fjalës dhe përgjegjësinë që kanë para qytetarëve dhe të tregojnë nivelin më të lartë të respektit për profesionin e gazetarit dhe medias. Kjo është pjesë e standardeve të përcaktuara në Kodin e Sjelljes në sferën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve, për të cilat partia politike e Majtë është angazhuar vullnetarisht.

Në lidhje me rastin e gazetarit Furkan Saliu, Agjencia më 7 prill i bëri thirrje Ministrisë së Punëve të Brendshme që menjëherë, pra sa më parë të zbardhë rastin dhe të informojë opinionin për arsyet e arrestimit të tij. Ndërkohë, Agjencia theksoi se pret që Ministria e Punëve të Brendshme të respektojë në vazhdimësi procedurat ligjore dhe të drejtat e gazetarit Saliu, si dhe partitë politike të mos e shfrytëzojnë këtë rast për qëllime partiake ditore, që të mos përhapen spekulime dhe dezinformata deri në zbardhjen e plotë të rastit.



## NEWSLETTER

Më 5 prill, përmes një njoftimi për media, është gjykuar sulmi verbal ndaj gazetares dhe kameramanit të TV 24 Vesti nga një person i panjohur, gjatë kohës së tubimit partiak të VMRO-DPMNE-së. Agjencia disa herë deri më tani ka reaguar dhe përsëri rikujton se sulmi ndaj gazetarëve të çfarëdo lloji është absolutisht i papranueshëm dhe se gazetarët nuk duhet të pengohen në kryerjen e detyrave të tyre profesionale.

### Mbikëqyrja e transmetuesve, ORRPKE, ofruesve të ASHMA-së sipas kërkesës dhe medias së shkruar

#### Transmetuesit

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi 99 transmetuesit që transmetojnë programe televizive apo radio, për detyrimin që deri më 31 mars në formular të posaçëm të paraqesin të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin paraardhës, totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve në një vit më parë, nga ofrimi i aktivitetit dhe për shikueshmërinë ose dëgjimin mesatar të vitit të kaluar. Mbikëqyrja ka rezultuar se këtë detyrim nuk e kanë përbushur radio Galaksi-2002 nga Kavadari dhe radio Pro-FM nga Gostivari. Është kryer mbikëqyrje e rregullt administrative mbi 98 transmetues për detyrimin që më së voni deri më 31 mars të publikojnë të dhënat për strukturën e pronësisë, redaksisë dhe burimet e financimit në vitin paraprak. Mbikëqyrja ka konstatuar se të gjithë transmetuesit e kanë përbushur detyrimin.

Për të konstatuar nëse ndonjë transmetues ka bërë ndryshim në strukturën e pronësisë pa e njoftuar më parë Agjencinë dhe para se të miratohet nga ASHMA, është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative mbi 40 televizione. Mbikëqyrja ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të LSHMAAV. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme administrative për përbushjen e detyrimeve të LSHMAAV dhe Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio është kryer mbi Televizionin G-TV nga Gostivari, ku është konstatuar se redaktori përgjegjës i televizionit është i punësuar nga transmetuesi në marrëdhënie të rregullt pune dhe me kohë të plotë.

#### Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët Datakom JV, Makedonski Telekom, Neotel dhe Spajder për detyrimin e pakos programore të cilën e ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë për ofrimin e shërbimeve programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje.

#### Ofruesit e ASHMA-së sipas kërkesës

Sa i përket detyrimeve që kanë të bëjnë me transmetimin e veprave kinematografike dhe mbrojtjen e të miturve, është bërë mbikëqyrje e rregullt programore mbi ofruesit e ASHMA-së me kërkesë të Makedonski Telekom, A1 Maqedoni, Svod Master dhe Mtel. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes programore nuk u konstatuan shkelje.

#### Media e shkruar

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi 21 botues të mediave të shkruara me qëllim të konstatimit nëse kanë publikuar të dhëna për strukturën e pronësisë, të dhëna për emrin dhe selinë e personave juridikë apo emrin dhe vendbanimin e personave fizikë që janë posedues të aksioneve apo pjesëmarrës të aksioneve në botuesin e medias me të dhëna për përqindjen e aksioneve ose të aksioneve që kanë marrë dhe datën e blerjes, të cilat janë të detyruar t'i publikojnë në të paktën një gazetë ditore, një herë në vit, më së voni deri më datë 31 mars të vitit aktual dhe klip të publikimit t'i dorëzojë organit rregullator kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit. Mbikëqyrja rezultoi se media e shkruar ka përbushur detyrimet ligjore.

#### Masat e shqiptuara paralajmërim publik

Në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja, Këshilli i Agjencisë në seancën e 14-të mbajtur më 8 prill 2024, ka miratuar dy Akvendime për shqiptimin e masës vërejtje publike. Njëra për operatorin kabllor SPAJDER SHPK nga Gjevgjelia për ritransmetim të shërbimit programor i cili nuk është i regjistruar në Agjenci dhe i dyti për median e shkruar KOLOR MEDIA PLUS nga Shkupi, botues i "The Economist" sepse në botimin nr.6 nga dhjetori 2023 nuk ka publikuar të dhënat për adresën e selisë së botuesit të medias së shkruar dhe të dhëna për adresën e redaksisë.

